



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr.464/01-57437

Datë: 03.05.2024

Në bazë të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik për ndërtimin e segmenteve rrugore “Bashkim Krasniqi” në Lipjan, të Njesisë kadastrale P-71409044-01171-3 me sipërfaqe prej 76m² në Zonën Kadastrale Lipjan në emër të Sadat Ejupi nga Lipjani.

II. Pjesë e këtij Vendimi është Akti i Vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

III. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë të Republikës së Kosovës të datës 12.06.2023.

IV. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Ineresit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për

kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/1-205 datë.28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

V. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Infrastrukturë.

VI. Ky vendim paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VII. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njëërën nga gazetatat me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Sadat Ejupi, Rr."Bashkim Krasniqi" në Lipjan
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Infrastrukturë
- Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

